



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
 HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
 VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.



Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bill Klinton" Br.13 Priština, Kosovo  
 Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@ iber-lepenc.org

## Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori i Jashtëm

Vendimi : (VII)

 REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org Unit	0113	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1300
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	-	Data Datum Date:	29.06.18
PRISHTINË/A			

Miratohet Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori i Jashtëm për vitin 2017.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi:	U.D. Kryesues i BD:
Nënshkrimi	Berat Lushtaku	Liridon Zogjani
Data: 28.06.2018		



**NH "IBERLEPENC" Sh.A**  
**Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017**

**LETËR E MEANXHMENTIT**



Sejdi Kryeziu 15, Floor 3, Pejton  
10 000 Prishtina, Kosovo

T: + 381 (0)38 226 942  
F: + 381 (0)38 226 946

info@bakertillykosovo.com  
www.bakertillykosovo.com

30 MARS 2018

## **LETËR E MENAXHMENTIT**

### **Për: menaxhmentin e NH“IBERLEPENC” Sh.A**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NH“IBERLEPENC” Sh.A për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017. Në planifikimin dhe kryerjen e auditimit, ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme të kompanisë mbi raportimin financiar si bazë për dizajnimin e procedurave të auditimit, kemi përfutur njohuri për efektivitetin e dizajnit të kontrollit të brendshëm, kemi përcaktuar nëse kontrollet e brendshme janë vendosur në operim, kemi vlerësuar rrezikun e kontrollit dhe kemi kryer testet e kontrollit të brendshëm të kompanisë me qëllim të dhënies së një opinionit mbi raportin financiar, por jo për qëllim të dhënies së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë mbi raportimin financiar.

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Është e mundur që informata shtesë mund të kenë ekzistuar por të cilat nuk janë përfshirë në ekzaminimet tona, e të cilat po të ishin lëndë shqyrtimi do të kishin mundur të ndryshojnë konkluzionet tona të auditimit.

Ky raport është vetëm për përdorim dhe qëllim të menaxhmentit të NH“IBERLEPENC” Sh.A dhe nuk i dedikohet dhe nuk duhet të përdoret nga askush tjetër përveç palëve të specifikuar.

Sinqerisht

Lulzim Berisha  
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo

## **1. Bordi i drejtorëve dhe zyrtarët kryesorë**

**Gjetja:** Gjatë vitit që mbaron më 31 Dhjetor 2017 vlera e stoqeve në depon në Shkabaj sipas librave të kontabilitetit dallon me numrimin fizik në të cilin ne ishim pjesëmarrës. Ne numërim fizik ne kemi konstatuar një ndryshim në vlerë prej 3,225 euro (*në njësi 10 copë*) e cila ekziston te stoku nr. 40 –Unaza azbesti fi 800 B.

### **Ndikimi:**

Vlera e stoqeve në total në depon Shkabaj në total është 345,222 euro dhe diferenca e konstatuar nga numërimi fizik është si pasojë e gabimeve të sistemit të kodimit dhe regjistrimit të stoqeve, sipas shpjegimeve të depoistëve ne nuk kemi mundur të kënaqim vetën tonë me arsyen se këto gabime kanë qenë lëshime teknike në sistemin e kodimit e më pas në regjistrimit.

**Rekomandimi:** Ne kemi rekomanduar që të bëhet rinumrim i stoqeve në depon Shkabaj dhe në depot tjera përmes një komisioni të profesionalizuar për të arritur deri në një barazim të gjendjes së stoqeve në libra të kontabilitetit dhe gjendjes fizike.

### **Komentet e Menaxhmentit:**

*Ne kemi kryer këtë korrigjim sipas rekomandimit të audituesit dhe është përfshirë në pasqyra financiare.*

### **Komentet e auditorit:**

Ne si auditor mendojmë që ndryshimet si rrjedhojë e një rinumrim eventual të stoqeve në deponinë në Shkabaj dhe depot tjera do të mund të rezultojnë me ndryshime të mëdha mes gjendjes në libra dhe gjendjes fizike të stoqeve e të cilat mund të paraqesin vlerë materiale, në një të ardhme mund të ketë implikime mbi opinionin e dhënë mbi pasqyrat financiare.

**N.H. IBER LEPENC SH.A.**

**Pasqyrat financiare**

**Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017**

**dhe**

**Raporti i auditorit të pavarur**

## Përmbajtja

	Page
<b>Raporti i auditorit të pavarur</b>	<b>3</b>
<b>Pasqyrat financiare</b>	
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhës së parase	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9



**BAKER TILLY  
KOSOVO**

Sejdi Kryeziu 15, Pejton  
10 000 Prishtina, Kosovo

T: + 381 (0)38 609 060  
F: + 381 (0)38 609 061

info@bakertillykosovo.com  
ëëë.bakertillykosovo.com

## **RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR**

Për: Menaxhmentin e NH. Ibër Lepenci Sh.a.

### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NH. Ibër Lepenci Sh.a., të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2017 dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parase për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç për efektet e mundshme të çështjes së përshkruar në paragrafin e bazës për opinionin të kualifikuar pasqyrat financiare janë paraqitur drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2017 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parase për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për kualifikim opinionit**

-Siç është shpjeguar në shënimin 7, Llogaritë e arkëtueshme tregtare prej 1,689,212 Euro me 31 dhjetor 2017 paraqesin obligimet e klientëve kryesor të kompanisë. Kompania nuk ka njohur lejime për borxhe të këqija duke marrë parasysh se ka borxhe të vjetra për të cilat kompania ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore por megjithatë salldoja e llogarive të arkëtueshme është rritë si rezultat i mos inkasimeve të rregullta. Në përmes procedurave alternative të auditimit nuk kemi arritur të vlerësojmë shumën e saktë të llogarive që duhet të shlyhen dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare. Prandaj gjendja e llogarive të arkëtueshme me 31 dhjetor 2017 është e mbivlerësuar për shumën e borxheve të pashlyera.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin.

**Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**  
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likudojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprimit në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijmësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfutur e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfutur deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çtardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

13 Prill 2018

Lulzim Berisha  
Auditor ligjor  
**BAKER TILLY**  
**KOSOVO**  
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo



**N.H. IBER LEPENC SH.A.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**  
 Me 31 dhjetor 2017  
 (Vlerat në Euro)

Shënime	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016	
<b>Pasuria</b>			
<b>I. Pasuria joqarkulluese</b>			
Prona dhe pajisjet	5	117,741,048	122,288,204
<b>Gjithsej Pasuria joqarkulluese (I)</b>		<b>117,741,048</b>	<b>122,288,204</b>
<b>II. Pasuria qarkulluese</b>			
Stoqet	6	1,222,748	1,263,197
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7	1,689,212	1,482,766
Kërkesat tjera afatshkurta	8	12,076	6,245
Parapagimi	9	4,295	6,022
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	10	388,354	205,536
<b>Gjithsej Pasuria qarkulluese(II)</b>		<b>3,316,684</b>	<b>2,963,766</b>
<b>GJITHSEJ PASURIA (I+II)</b>		<b>121,057,732</b>	<b>125,251,970</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali aksionar</b>			
<b>I. Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Fitime të mbajtura		(38,082,522)	(33,687,179)
Rezerva e rivlerësimit		162,424,909	162,424,909
Fitimi i vitit aktual/(humbja)		(4,177,032)	(4,395,344)
<b>Gjithsej Kapitali aksionar (I)</b>		<b>120,190,354</b>	<b>124,367,386</b>
<b>II. Detyrimet afatgjata</b>			
Kredia afatgjatë			
Të hyrat e shtyera	11	490,765	477,669
<b>Gjithsej Detyrimet afatgjata (II)</b>		<b>490,765</b>	<b>477,669</b>
<b>III. Detyrimet afatshkurta</b>			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	12	134,270	142,961
Tatimet dhe detyrimet të tjera		20,882	33,894
Detyrimet tjera afatshkurta	13	221,460	230,060
<b>Gjithsej Detyrime afatshkurta (III)</b>		<b>376,612</b>	<b>406,915</b>
<b>GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR DHE DETYRIMET</b>		<b>121,057,732</b>	<b>125,251,970</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.  
 Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga Djetori Ekzekutiv me 15 Shkurt 2018.

Kryeshefi Ekzekutiv  
 Sami Veliu



Zv. Drejtor Financiar  
 Myzele Jusufi

**N.H. IBER LEPENC SH.A.**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017  
*(Vlerat në Euro)*

<b>Për vitin që përfundon me:</b>	<b>Shënimi</b>	<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>Me 31 dhjetor 2016</b>
<b>I. Të hyrat</b>			
Të hyrat nga shitja	14	4,204,157	3,882,130
<b>Gjithsej të hyra (I)</b>		<b>4,204,157</b>	<b>3,882,130</b>
<b>II. Shpenzimet</b>			
Pagat		3,052,870	3,003,414
Shpenzimet operative	15	684,453	621,914
Shpenzimet e Zhvlerësimit	5	4,643,866	4,652,146
<b>Gjithsej shpenzimet (II)</b>		<b>8,381,189</b>	<b>8,277,474</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit (I - II)</b>		<b>(4,177,032)</b>	<b>(4,395,344)</b>
Tatimi mbi fitimin	16		
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit</b>		<b>(4,177,032)</b>	<b>(4,395,344)</b>

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**N.H. IBER LEPENC SH.A.**

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

	<u>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016</u>
Kapitali pronarit	25,000	25,000
Fitime të pashpërndara	(38,082,522)	(33,687,179)
Fitimi / (Humbla) për vitin	(4,177,032)	(4,395,344)
Rezerva e rivlerësimit	162,419,909	162,419,909
<b>Gjithsej</b>	<b><u>120,190,355</u></b>	<b><u>128,367,386</u></b>

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet lexuar së bashku me shënimet, pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

**N.H. IBER LEPENC SH.A.****Pasqyra e rrjedhjes së parasë**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

	Shënimi	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi (humbja) neto para tatimit		(4,177,032)	(4,395,344)
<i>Të korrigjuara për:</i>			
Zhvlerësimi	5	4,643,866	4,652,146
Humbja nga heqja e përdorimit të pajisjeve		2,349	-
(Rritja)/zvogëlimi në stocqe	6	40,449	54,945
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	7-9	(210,550)	(304,891)
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	11-13	(17,206)	(337,870)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>281,876</b>	<b>(331,014)</b>
Interesi I paguar		-	-
Tatimi I paguar	16	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)</b>		<b>281,876</b>	<b>(331,014)</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	5	(99,058)	(89,778)
Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje		-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)</b>		<b>(99,058)</b>	<b>(89,778)</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Kredi bankare		-	-
Tërheqjet e fitimit		-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)</b>		<b>182,818</b>	<b>(420,792)</b>
<b>V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>	10	<b>205,536</b>	<b>626,328</b>
<b>VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit (IV + V)</b>		<b>388,354</b>	<b>205,536</b>

## **NH IBËR LEPENC SH.A.**

### **Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Per vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

#### **1. Të përgjithshme**

a) NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është konstituuar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës të këtij sistemi shumë funksional. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga UNMIK-u. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Në vitin 2007 në "Ibër-Lepenc" ka përfunduar procesi i korporatizimit me të cilin është kryer edhe procesi i vlerësimit të asetëve dhe kështu nga data 1 janar 2008 ndërmarrja është regjistruar si shoqëri aksionare me emrin NH "Ibër-Lepenc" – Sh.A. Prishtinë. Në ndërkohë, me kërkesë të Njesisë për Politika dhe Monitorin të Ndërmarrjeve Publike, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74 të datës 14.07.2009 dhe Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1 të datës 30.09.2009, më 22.10.2009, janë kryer ndryshimet në statutin e ndërmarrjes sipas të cilave është shuar ish Ndërmarrja Holding dhe është sqaruar se NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është trashëgimtare e ish-Ndërmarrjes Publike dhe ish-Ndërmarrjes Holding. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje. Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/ L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

#### **b) Struktura e kapitalit:**

"Ibër-Lepenc"-i është njëra nga tetë ndërmarrjet publike qendrore të Republikës së Kosovës e organizuar si shoqëri aksionare e cila përmes Bordit të drejtorëve i përgjigjet drejtpërdrejt Qeverisë së Kosovës si aksionar i vetëm. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/ L-087), Qeveria e Republikës së Kosovës, ka emëruar Bordin e drejtorëve, i cili më 26.06.2009, ka aprovuar Statutin e ri të ndërmarrjes, të organizuar si ndërmarrje e nivelit qendror, përkatësisht ndërmarrje e Republikës së Kosovës, aksionar i të cilës në lartësi 100% është Qeveria e Republikës së Kosovës.

c) Ndërmarrja kryen veprimtarinë e vet duke bërë furnizimin me ujë të patrajtuar për qëllime të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, për kompanitë rajonale të ujesjellësve, për shfrytëzuesit industrial dhe gjeneron energji elektrike nga hidrocentrali në Ujman.

d) Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2017 është 275

e) Selia e ndërmarrjes është në Prishtinë, Sheshi "Bill Clinton", nr.13

#### **2. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të ndryshuara Ndryshimet në SNRF që janë të obligueshme dhe efektive për vitin aktual.**

Në vitin aktual, Kompania ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme për periudhat kontabël që fillojnë me ose pas 1 janar 2017.

##### **Ndryshimet në SNK 7 Iniciativa e Shpalosjeve**

Kompania ka zbatuar ndryshimet për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet kërkojnë që entiteti të ofrojë shpalosje për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet nga aktivitetet financiare, përfshirë ndryshimet monetare dhe jo-monetare.

##### **Ndryshimet në SNK 12 Njohja e Pasurive të Tatimit të Shtyrë për Humbjet e Perealizuara**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se si entiteti duhet të vlerësoj nëse do të ketë fitime të mjaftueshme të tatueshme në të ardhmen kundrejt të cilave mund të përdor diferencat e përkohshme të zbritshme.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që kompania tashmë ka vlerësuar mjaftueshmësinë e fitimeve të ardhshme të tatueshme në atë mënyrë që të jetë në konsistencë me këto ndryshime.

## **NH IBËR LEPENC SH.A.**

### **Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)*

#### **Përmirësimet vjetorë të SNRF – cikli 2014-2016**

Kompania ka zbatuar ndryshimet në SNRF 12 të përfshira në ciklin e përmirësimeve vjetore 2014-2016 për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet tjera të përfshira në këtë pako nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar më herët nga Kompania.

SNRF 12 thekson se një entitet nuk duhet të ofrojë informata të përmbledhura financiare për interesat në filiale, investime në shoqëri ose ndërmarrje të përbashkëta të cilat janë klasifikuar (ose përfshirë në grupin për tu shitur që është klasifikuar) si të mbajtura për shitje. Ndryshimet qartësojnë se ky është përjashtimi i vetëm nga kërkesat për shpalosje të SNRF 12 për këto interesa.

Zbatimimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që asnjë nga interesat në këto entitete nuk është klasifikuar ose përfshirë në grupin për shitje i cili është klasifikuar si i mbajtur për shitje.

#### **Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Kompania. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të Kompanisë për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

#### **SNRF 9 Instrumentet financiare**

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për riklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të 'humbjes së pritur kreditore' për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron ushëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

#### **SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët**

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të hyrat', SNK 11 'Kontratat ndërtimore' dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustrojnë transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

#### **SNRF 16 Lizingu**

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jashtë bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofrojë informata të kuantifikuara.

## **NH IBËR LEPENC SH.A.**

### **Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)*

#### **3. Politikat e kontabilitetit**

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të ndërmarrjes të cilat janë zbatuar në përgaditjen e pasqyrave financiare:

##### **3.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të adoptuara në Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

##### **3.2. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në harmoni me konventën e kostos historike e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në vlerën e rivlerësuar.

Politikat e kontabilitetit janë konsistente, pra politikat e njëjta kontabel që janë miratuar më parë aplikohen në mënyrë të njëjtë nga një periudhë në tjetrën. Pasqyrat financiare janë përgaditur në baza krahasuese duke i paraqitur saldot e zërave për vitin vijues dhe vitin e kaluar.

Valuta raportuese në evidencën e NH "Ibër-Lepenc" SH.A. dhe pasqyrat financiare është valuta Euro (€). Transaksionet në valuta tjera përveç euros nëse ka pasur janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

Periudha raportuese e ndërmarrjes përfshinë periudhën dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 dhjetor të çdo viti.

##### **3.3. Valuta e prezantimit**

Valuta prezantuese dhe raportuese e Ndërmarrjes është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

##### **3.4. Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjdhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë. Asetet dhe detyrime monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diferencë ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.

##### **3.5. Prona, impiantet dhe pajisjet**

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve me 1 Janar 2008 deklarohen sipas koston së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi, përderisa artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera pas 1 Janarit 2008 deklarohen sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi nëse ka pas.

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuar nga Ndërmarrja me ndihmën e një konsulenti të pavarur (PC&A) më 31 Dhjetor 2007.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bariëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, verëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet rre besueshmëri.

## NH IBËR LEPENC SH.A.

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

Zhvlerësimi i aseteve flogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre ose shumën e rivlerësuar në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

		Shkallët e zhvlerësimit sipas vlerësuesve								Sipas Ligjit Nr.03/L-113 dhe A. Tatimore
		Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014	Viti 2013	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2010	
1	Ndërtesat	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	5%	
2	Pajset e rënda industriale	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	10%	
3	Veturat	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	20%	
4	Pajset për zyrtë dhe kompjuterë	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	20%	

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërmarrja me politikën e pranuar të kontabilitetit lidhur me rivlerësimin dhe dëmtimin e mjeteve jo financiare kërkon në çdo datë të bilancit të gjendjes që zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të rivlerësohen dhe rishikohen për dëmtim, kurdoherë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë që vlera bartëse e një mjeti nuk mund të jetë e rikuperueshme.

### 3.6. Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuterë. Këto fillimisht deklarohen sipas koston e tyre dhe më pas sipas koston minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përdërisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

### 3.7. Asetet dhe detyrimet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare që ndodhen në bilanc të gjendjes përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parashë të gatshme, flogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikën e kontabilitetit mbi njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikën përkatëse të kontabilitetit që janë të përfshira në këtë shënim. Ndërmarrja i klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes së ndërlidhur kontraktuale. Interesat, fitimet dhe humbjet që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si asete ose detyrime raportohen si të hyra ose shpenzime, respektivisht. Instrumentet financiare thyhen kur Ndërmarrja ka një të drejtë të zbatuar me ligj për të bërë thyerjen dhe ka për qëllim që ta zgjidh ose në baza neto apo që të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

## NH IBËR LEPENC SH.A.

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

#### 3.8. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen sipas vlerës së tyre reale dhe praktikohet provizioni për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare për shkak që Ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë borxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

#### 3.9. Stokset

Stokset vlerësohen sipas SNK2 që do të ftohtë sipas kostos më të ulët ose vlerës neto të realizuar, dhe raportohen jo më shumë se shumat e pritura të realizohet nga shitja ose përdorimi. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus kostot e vlerësuara të nevojshme për ta kryer shitjen. Kur kostoja e një artikulli të stokeve e tejkalon vlerën neto të realizueshme, ky tejkallim do të evidentohet si humbje në pasqyrën e të ardhurave. Kostoja e stokeve është e përcaktuar në bazë të formulës "I pari Brenda - I pari jashtë" apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stokset e blera me çmimin e parë i trajton dalje të para.

#### Njohja e të hyrave

Njohja e të hyrave bëhet vetëm kur dobia (përfitimet) ekonomike e shoqëruar me transaksion pranohet nga ndërmarrja pra kur të hyrat realizohen dhe kur ato mund të maten me saktësi. Të hyrat në ndërmarrje janë në pjesën më të madhe të hyra që realizohen nga veprimtaria e regjistruar e ndërmarrjes.

Të hyrat nga shitja njihen kur ndërmarrja transferon të blerësi rrezikun dhe pronësinë, nuk mban kontroll efektiv mbi mallrat që janë shitur, kur shumat e të hyrave mund të maten me saktësi, pritet të marrë një pagesë (është e besueshme se përfitimi ekonomik do të rrjedhë) dhe shpenzimet lidhur me transaksionin mund të maten me saktësi.

#### 3.10. Njohja e shpenzimeve

Njohja e shpenzimeve bëhet vetëm kur pasuritë ekonomike të ndërmarrjes të shoqëruara me transaksione konsumohen për prodhimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave vetëm kur ato ndodhin sipas parimit aktual të kontabilitetit.

#### 3.11. Kontributi shtesë për të punësuarit

Ndërmarrja duke u bazuar në moshën mesatare të të punësuarve, kontributin e tyre në ndërmarrje, procedurave aktuale të pensionimit, përveç kontributit pensional të obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi ka vendosur politika të ndarjes së kontributeve shtesë për të punësuarit. Këto kontribute shtesë i ngarkojnë shpenzimet e pagave në pasqyrat e të ardhurave sipas periudhave kohore kur ndodhin. Që nga muaji Mars 2010, Ndërmarrja ka ndërprerë pagesën e kontributit shtesë për të punësuarit.

#### 3.12. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Mjetet në llogaritë bankare duke përfshirë edhe paratë në arkë janë të paraqitura në saldot e tyre në vlerë nominale në valutën aktuale në Kosovë në Euro (€). Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paratë në dorë dhe depozitat e mbajtura në llogari bankare të paafatizuara.

#### 3.13. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera monetare e aksioneve të regjistruara në vlerë prej 25.000 € e caktuar nga aksionari i ndërmarrjes.

## **NH IBËR LEPENC SH.A.**

### **Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)*

#### **3.14. Politikat tatimore**

Në bazë të organizimit si ndërmarrje publike me statut të shoqërisë aksionare, ndërmarrja ju nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të cilat rregullojnë lëmi të caktuara në të cilat aplikohet tatimi në vlerën e shtuar, kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura personale si dhe sipas Ligjit Nr.03/L-113 për Tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat e tatueshme të korporatave me normë prej 10% i kalkuluar sipas Deklaratës vjetore të tatimit në fitim.

#### **3.15. Njohja e granteve qeveritare**

SNK 20 (Grantet qeveritare dhe asistenca e teknikës qeveritare) – Grantet qeveritare do të njihen vetëm atëherë kur ka siguri të arsyeshme se ndërmarrja do të plotësojë kushtet e grantit dhe granti do të merret, dhe ato aplikohen sipas metodës së të ardhurave.

#### **3.16. Politika e vazhdimt të veprimtarisë**

Ndërmarrja ka të aprovuar planin trevjeçar 2016-2019 ku janë paraqitur synimet dhe objektivat e ndërmarrjes në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e asetëve dhe shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve që do të siguronin edhe ngritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

#### **3.17. Politika e rritjes së kontrollit të brendshëm**

Pas transformimit në shoqëri aksionare me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm, ndërmarrja sipas Ligji për Shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) ka punësuar Zyrtarin për Auditim të Brendshëm.

### **4. Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar**

Në vitin aktual, Kompania ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Nërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2016.

#### **Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa e shpalosjeve**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se entiteti nuk ka nevojë të ofrojë shpalosje specifike të kërkuar nga SNRF nëse informata rezultuese nga shpalosja nuk është materiale dhe ofron udhëzime për bazën e agregimit dhe disagregimit të informatave për qëllime të shpalosjes. Mirëpo, ndryshimet ritheksojnë se entiteti duhet të konsideroj ofrimin e shpalosjeve shtesë kur pajtueshmëria me kërkesën specifike në SNRF është e pamjaftueshme për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve specifike mbi pozitën financiare dhe performancën financiare të entitetit.

Sa i përket strukturës së pasqyrave financiare, ndryshimet ofrojnë shembuj të rradhitjes ose grupimit sistematik të shënimeve.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka rezultuar më ndonjë ndikim në performancën financiare ose pozitën financiare të Kompanisë.

**NH IBËR LEPENC SH.A.****Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)*

**Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit**  
Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet në SNK 16 ndalojnë entitetet të përdorin zhvlerësimin e bazuar në të hyra si metodë të zhvlerësimit për zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Ndryshimet në SNK 38 paraqesin supozime të kundërshtueshme se të hyrat nuk janë bazë e duhur për amortizimin e një pasurie të patrupëzuar. Ky supozim mund të kundërshtohet në dy rrethanat e kufizuara në vijim.

- Kur pasuria e patrupëzuara është shprehur si masë e të hyrave; ose
- Kur mund të demonstronohet se të hyrat dhe konsumimi i përfitimit ekonomik i pasurisë së patrupëzuar janë në një korelacion të lartë.

Pasi që Kompania tashmë përdor metodën drejtëvizore të zhvlerësimit dhe amortizimit për pasuritë joqarkullese dhe pasuritë e patrupëzuara përkatësisht, zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

**Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësia: Bimët bartëse**

Kompania ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet përkufizojnë bimët bartëse dhe kërkojnë që pasuritë biologjike që përmbushin përkufizimin e një bime bartëse të trajtohet si pronë, impiant dhe pajisje në pajtueshmëri me SNK 16, në vend të SNK 41. Frytet që rriten në bimët bartëse vazhdojnë të trajtohen në pajtueshmëri me SNK 41.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që Kompania nuk është përfshirë në aktivitetet bujqësore.

**5. OBJEKTET NDËRTIMORE, MAKINERITË E RËNDA DHE PAJISJET**

	Objektet ndërtimore	Makineritë e rënda	Pajisjet dhe inventari	Gjithsej
<b>Kosto</b>				
Me 01 janar 2016	278,842,304	4,151,110	7,774,119	290,767,533
Shtesat	83,504	-	6,662	90,166
(Heqjet)	-	-	-	-
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>	<b>278,925,808</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,780,781</b>	<b>290,857,699</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
Me 01 janar 2016	(153,950,294)	(2,656,709)	(7,310,345)	(163,917,349)
Shpenzimi për periudhën	(4,442,537)	(83,022)	(126,587)	(4,652,146)
(Shtesa)/Heqje	-	-	-	-
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>	<b>(158,392,831)</b>	<b>(2,739,731)</b>	<b>(7,436,932)</b>	<b>(168,569,495)</b>
<b>VNL ME 31 DHJETOR 2016</b>	<b>120,532,977</b>	<b>1,411,379</b>	<b>343,849</b>	<b>122,288,204</b>
<b>Kosto</b>				
Me 01 janar 2017	278,925,808	4,151,110	7,780,781	290,857,699
Shtesat	81,143	-	17,915	99,058
Shtesa/(Heqje)	-	-	(50,182)	(50,182)
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>279,006,951</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,748,514</b>	<b>290,906,575</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
Me 01 janar 2017	(158,392,831)	(2,739,731)	(7,436,932)	(168,569,494)
Shpenzimi për periudhën	(4,442,598)	(83,022)	(118,247)	(4,643,866)
(Shtesa)/Heqje	-	-	47,834	47,834
<b>Me 31 dhjetor 2017</b>	<b>(162,835,429)</b>	<b>(2,822,753)</b>	<b>(7,507,345)</b>	<b>(173,165,527)</b>
<b>VNL ME 31 DHJETOR 2017</b>	<b>116,171,522</b>	<b>1,328,357</b>	<b>241,169</b>	<b>117,741,048</b>

**NH IBËR LEPENC SH.A.****Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)***6. STOQET**

Stoqet	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Pjesë rezerve dhe materiale	1,222,748	1,263,197
<b>Gjithsej</b>	<b>1,222,748</b>	<b>1,263,197</b>

Saldo në fillim të vitit:	1,263,197
Blerjet gjatë vitit:	30,277
Shpenzimet gjatë vitit:	(70,726)
<b>Saldo në fund të vitit:</b>	<b>1,222,748</b>

**7. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA**

Llogaritë e arkëtueshme	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
LL.A. nga shitja e Energj. Elek.	180,333	129,958
LL.A. nga shitja e Ujit industrial	1,143,763	1,112,764
LL.A. nga Ujitja	261,704	240,044
LL.A Ferronikeli Complex	103,172	-
Të tjera të arkëtueshme	241	-
<b>Gjithsej</b>	<b>1,689,212</b>	<b>1,482,766</b>

Nga totali i vlerës së llogarive të arkëtueshme vetëm nga klienti Ujësullësi Rajonal Mitrovica me 31 dhjetor 2017 është 911,560 (apo rreth 54% e totalit të llogarive të arkëtueshme). Gjatë vitit 2017 është falur një borxh në vlerë prej 20,586 euro në pajtim të dy palëve sipas procedurave ligjore dhe statutore.

Për vitin që mbaron me 31 dhjetor 2017 kërkesat ndaj klientit në fjalë nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim domethënës pos asaj që është cekur më lartë.

**8. KËRKESAT TJERA AFATSHKURTA**

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Kërkesat nga punëtorët dhe përmbaruesi	12,076	6,002
Kërkesat nga interesi i bankës	-	242
<b>Gjithsej</b>	<b>12,076</b>	<b>6,245</b>

**9. PARAPAGIMET**

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Parapagimet	4,295	6,022
<b>Gjithsej</b>	<b>4,295</b>	<b>6,022</b>

## NH IBËR LEPENC SH.A.

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

#### 10. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Llogaritë në banka	362,058	178,647
Arka	1,296	1,888
Kapitali themeltar	25,000	25,000
<b>Gjithsej:</b>	<b>388,354</b>	<b>205,536</b>

#### 11. TË HYRAT E SHTYRA

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Të hyrat e shtyra - BE	462,252	477,669
Të hyrat e shtyra nga përmbartimi	28,513	-
<b>Gjithsej</b>	<b>490,765</b>	<b>477,669</b>

Grantet nga projekti me BE-në për vitin 2017 janë në vlerë 462,252 Euro të cilat paraqesin pajisje dhe stocq, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 28,513 Euro paraqesin të hyrat e shtyra nga kamata apo interesi aplikuar ndaj blerësve.

Sipas SNK 20 donacionet duhet të zhvlerësohen në bazë të normës së paracaktuar të zhvlerësimit ose në bazë të marrëveshjes me donatorin në këtë rast BE dhe e hyra nga donacioni të njihet në nivel të shpenzimit të ndodhur ndërsa pjesa e mbetur pozicionohet si e hyrë e shtyrë, ky trajtim i të hyrave nga grantet konsiston në aplikimin e metodës së të ardhurave ku donacioni nuk kreditohet direkt interesave të aksionarëve por kalon nga pasqyra e të ardhurave. Grantet qeveritare duhet të njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'u krahasuar ato me kostot respektive që ato kanë për qëllim të kompensojnë, në mënyrë sistematike.

Emërtimi	Gjendja 2016	Grantet 2017	Shpenzimet 2017	Gjithsej
Pajisje – mjete themelore:	227,047	-	5,102	221,945
Materiali	241,451	-	1,143	240,307
Të hyrat e shtyra tjera	9,171	19,442	100	28,513
				<b>490,765</b>

#### 12. TË PAGUSHMET TREGTARE DHE TË TJERA

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Kek Dispeqinq-Prishtina	3,931	4,627
Kek Dispeqinq-Mitrovica	15,011	22,453
PTK Prishtinë	2,408	811
Furnitor të tjerë	112,920	115,070
<b>Gjithsej</b>	<b>134,270</b>	<b>142,961</b>

Paraqesin pjesën e detyrimeve ndaj furnitorëve me datë 31 dhjetor 2017 respektivisht 2016. Kryesisht furnitorët janë vendor. Këto hapje dhe mbyllje të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme subjekti i ka regjistruar konform SNK dhe SNRF. Subjekti në sistemin e tij të kontabilitetit aplikon listën e llogarive të pagueshme me salldot përfundimtare të secilit furnitor dhe paraqet bruto gjendjen e secilit furnitor.

**NH IBËR LEPENC S.H.A.****Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)***13. DETYRIMET TJERA AFATSHKURTA**

	Me 31.12.2017	Me 31.12.2016
Tatimi në paga	166,761	16,218
Të tjera (TVSH, Kontribute, tatim në interes,)	54,699	52,374
<b>Gjithsej</b>	<b>221,460</b>	<b>211,553</b>

**14. TË HYRAT**

Për vitin që përfunon me	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të hyrat nga energjia elektrike	2,060,878	2,369,768
Të hyrat nga shitja e ujit	1,898,107	1,326,578
Të hyrat nga uji	153,082	156,262
Të hyrat nga kamata	42,840	-
Të hyrat nga KOST	36,896	-
Të hyrat tjera (granti, interesi, rimbursimet)	12,355	29,522
<b>Gjithsej</b>	<b>4,204,157</b>	<b>3,882,130</b>

Të hyrat kompania i ndan në atë të shitjeve (që përmbledhin shumën e të ardhurave që kompania gjeneron nga shitja). Të gjitha të ardhurat njihen sipas metodës akruale që nënkupton se të hyrat njihen atëherë kur fitohen e jo vetëm atëherë kur pranohen.

Të hyrat nga energjia elektrike dhe të hyrat nga shitja e ujit përfaqësojnë rreth 94% të të hyrave në total të Ibër Lepenc S.H.A. Në krahasim me vitin paraprak të hyrat nga energjia elektrike kanë pasur rënie (jo domethënëse) ndërsa të hyrat nga shitja e ujit janë rritur në krahasim me vitin paraprak.

Të hyrat në total në krahasim me vitin paraprak janë rritur për 8%.

Të hyrat nga kamata përfaqësojnë të hyrat e realizuara nga blerësit përmes përmblyesit.

**15. SHPENZIMET OPEARTIVE**

Për vitin që përfundon me	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mirëmbajtja/riparimet	15,331	23,429
Shpenzimet administrative	48,127	45,480
Rryma elektrike	288,344	251,576
Derivatet	29,724	33,996
Shpenzimet për shërbime	65,830	53,451
Mallra dhe material	38,648	48,981
Shlyerja e borxheve të këqija	22,898	-
Material harxhues dhe taksa	175,552	165,001
<b>Gjithsej</b>	<b>684,453</b>	<b>621,914</b>

Shpenzimet operative janë rritur në krahasim me vitin paraprak, por në proporcion me rritjen e të hyrave konstatojmë se eficaenca e përdorimit të burimeve ka qenë pothuajse e njëjtë me vitin e kaluar. Nuk ka pasur ndonjë rritje/(rënie) domethënëse të ndonjë zëri të shpenzimeve operative që mund të jetë materiale ose të tërheqë vëmendjen përdoruesve të pasqyrave financiare të kompanisë. Shpenzimet operative nga viti 2016 janë rritur rreth 10%.

## NH IBËR LEPENC SH.A.

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

#### 16. TATIMI NË FITIM

Tatimi në të ardhurat e korporatave është përfshirë në pasqyrat financiare në pajtim me legjislacionin tatimor në Kosovës: Ligjit nr.-05-L./029 për vitin 2017 dhe rregulloret tjera plotësuese aktuale sipas këtij ligji tatimi në fitim është 10 %.

<b>Për vitin që përfundon:</b>	<b>31.12.2017</b>	<b>31.12.2016</b>
Fitimi/(humbja) para tatimit	(4,177,032)	(3,773,430)
<b>Korrigjim për:</b>		
Të hyrat e pa tatueshme	-	-
Shpenzimet e papranueshme	-	-
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>(4,177,032)</b>	<b>(3,773,430)</b>
Tatimi në fitim 10%	-	-
Tatimi i shtyrë në bazë të ligjit	-	-
Tatimi për pagesë	-	-
<b>Fitimi/(Humbja) neto</b>	<b>(4,177,032)</b>	<b>(3,773,430)</b>

#### 16. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

##### 16.1 Faktorët e riskut financiar

Aktivitetet e kompanisë e vënë atë në një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqendrohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizoj efektet e mundshme negative mbi performansën e biznesit të kompanisë. Menaxhimi i riskut kryhet nga Menaxhmenti i Kompanisë të bazuar në disa politika dhe procedura paraprakisht të aprovuara me shkrim që mbulon plotësisht menaxhimin e riskut, si edhe zona të veçanta, të tilla si risku i këmbimit valutor, riskut i normës së interesit, risku i kredisë, përdorimit të letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimit përtej likuiditetit.

##### 16.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën titujve të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

##### Risku i monedhës

Në përgjithësi, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që shumica e shitjeve të saj, blerjeve dhe huazimeve janë në valutën Euro.

## NH IBËR LEPENC SH.A.

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro)

#### 16.3 Risku i kredisë

Risku i kredisë është risk në humbjen financiare të kompanisë, nëse një klient ose homolog i një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij të kontraktuara, dhe linden kryesisht nga të arkëtueshme të kompanisë prej klientëve dhe investimeve në letra me vlerë.

#### Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Ky ekspozim mund të varet nga risku i mos pagesës në industri dhe tregun e brendshëm në të cilën vepron Kompania.

Kompania krijon një lejim për dëmtimet që pasqyrojnë vlerësimet e saj të humbjeve të shkaktuara në lidhje me të arkëtueshmet tregtare, të arkëtueshmet tjera dhe investimet. Komponentët kryesorë të këtyre lejimeve janë komponentë të veçantë të humbjes që ka të bëjë me ekspozimet individuale të rëndësishme, dhe një komponentë e përbashkët e humbjes e themeluar për asetet të ngjashme të kompanisë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur, por ende të pa identifikuar. Lejimi për humbjet e përbashkëta është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për asete të ngjashme financiare.

#### 16.4 Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjatë, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parashikuara nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vërtetim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë.

Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vërtetim.

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<b>ASETET</b>		
Paratë në bankë	388,354	205,536
Stoqet	1,222,748	1,263,197
Të arkëtueshmet tregtare	1,689,212	1,482,766
Kerkesat tjera afatshkurta	12,076	6,245
Parapagimet	4,295	6,022
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>3,316,685</b>	<b>2,963,766</b>
<b>DETYRIMET</b>		
Detyrimet tregtare dhe tjera	134,270	142,961
Detyrimet tjera afatshkurta	20,882	230,060
Tarimet dhe detyrimet tjera	221,460	33,894
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>376,612</b>	<b>406,915</b>
<b>HAPËSIRA E LIKUIDITETIT</b>	<b>2,940,073</b>	<b>2,556,851</b>

**NH IBËR LEPENC SH.A.****Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

*(Vlerat në Euro)***18. NGJARJET PASUESE**

Si ngjarje pasuese pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që duhet të shpaloset janë inkasimet e shitjeve me kredi, përkatësisht nga shuma totale e llogarive të arkëtueshme me datë 31 dhjetor 2017 (1,689,212), deri me datë 21 mars 2018 janë arkëtuar këto të hyra:

<b>Blerësit</b>	<b>Euro</b>
KESCO	117,850
TC "Kosova B"	62,482
KUR Prishtina-Drenas	23,678
KUR Prishtina-Shkabaj	142,040
KRU "Mitrovica"	255,569
KRU "Mitrovica"-Vushtrri	17,576
Ujitja	10,279
<b>Gjithsej</b>	<b>629,472</b>

Këto inkasime janë incim i kompanisë në angazhimin e përmblyesve, vlenë të ceket se këto inicime për inkasimin e shitjeve me kredi janë ndermarrë gjatë vitit 2017.

01609 Dt. 16.03.2018  
 PRISHTINË - PRIŠTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
 HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
 VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bill Clinton" Br.13 Priština, Kosovo  
 Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@iber-lepenc.org

## Raport Vjetor 2017 për NH "Ibër Lepenc "Sh.A

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nivelo Org. Org. Jedin. Org. Unit	0113	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	484
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	16.03.18
PRISHTINË/A			

### Vendimi : (IV)

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.15.03.2018, pas shqyrtimit të Raportit Vjetor 2017, mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në kompani mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoj që i njëjti Raport të përcillet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	U.D Kryeshef Ekzekutiv	Kryesuesi i BD:
Nënshkrimi	Sami Veliu	Fatos Sahiti
Data: 15.03.2018		



Handwritten signatures in blue ink over the stamp and table, corresponding to Sami Veliu and Fatos Sahiti.